



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal
O1 Nr.006-833/1
Dt.23.01.2014
D r a g a s h

Në seancën e Kuvendit Komunal të Dragashit të dt.23.01.2014, pas votimit paraprak për rendin e ditës-me shumicë votash (14 “pro”,12 “kundër” dhe 1 “abstenim”), miratohet ky:

V E N D I M

I.HIQET nga rendi i ditës pika e 2-të e seancës së Kuvendit Komunal të Dragashit:”Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për formimin e 3 drejtorive të reja komunale”(që paraprakisht ishte në rend dite me materialin e seancës) e që,para miratimit të rendit të ditës së seancës u propozua dhe miratua si pikë “Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës-Dragash”.

A r s y e t i m

Kuvendi Komunal i Dragashit,në seancën e dt.23.01.2014,pas votimit paraprak, sipas rezultatit të larcekur,nuk e miratoi këtë pikë për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës-Dragash, përkatësisht shtimin e 3 drejtorive, mbështetur në nenin 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 8.4 të Statutit të Komunës-Dragash (ku kërkohet miratimi nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit, apo 18 delegatëve nga 27 delegatë).

I dërgohet:

- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal-Prishjinë,
- Kryetarit të Komunës-Dragash Salim Jenuzi, dhe
- Arkivit



KUVENDIKOMUNAL- DRAGASH

Kryesuesi

Shaban Shabani